

VENDIM
Nr. 1032, datë 27.11.2013

**PËR LEJIMIN E MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT PËR KRYERJEN E
PROCEDURËS SË PROKURIMIT, ME OBJEKT “BLERJA E SISTEMIT TË SHFRYTËZIMIT,
PAKETA *OFFICE DHE SOFTWARE*, PËR MENAXHIMIN E LABORATORËVE TË
INFORMATIKËS NË SHKOLLA” DHE TË BOTIMIT TË ÇDOLLOJ NJOFTIMI PROKURIMI
PËR KËTË SHËRBIM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 591, datë 10.7.2013 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2013”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për kryerjen e procedurës së prokurimit, me objekt “Blerja e sistemit të shfrytëzimit, paketa *office* dhe *software*, për menaxhimin e laboratorëve të informatikës në shkolla”, me fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit për vitin 2013 për këtë ministri, brenda datës 31 dhjetor 2013. Brenda këtij afati përfshihen lidhja e kontratës përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama